



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH .nr.17/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të z. Blerim Dina - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi – Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik “LAGUNA”SH.P.K-Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë grupi i operatoreve ekonomik OE: “Krasniqi” SHpk; NTP”Beni”- Prishtinë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Pastrimi i Shkollave fillore Gjergj Fishta, Ismail Qemaili, Asim Vokshi, Dardani, Naim Frashri, Pjeter Bogdani, Shkolla e Gjelbert dhe Mehmet Xhevari ” me nr. prokurimit: 616-19-3237-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- Kuvendi Komunal Prishtinë , më datë: 05.02.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “LAGUNA”SH.P.K-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Pastrimi i Shkollave fillore Gjergj Fishta, Ismail Qemaili, Asim Vokshi, Dardani, Naim Frashri, Pjeter Bogdani, Shkolla e Gjelbert dhe Mehmet Xhevari ” me nr. prokurimit: 616-19-3237-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- Kuvendi Komunal Prishtinë

II. VËRTETOHET, njoftimi për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Pastrimi i Shkollave fillore Gjergj Fishta, Ismail Qemaili, Asim Vokshi, Dardani, Naim Frashri, Pjeter Bogdani, Shkolla e Gjelbert dhe Mehmet Xhevari ” me nr. prokurimit: 616-19-3237-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- Kuvendi Komunal Prishtinë.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “LAGUNA”SH.P.K-Prishtinë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues “LAGUNA”SH.P.K-Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 06.01.2020 me nr 17/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Pastrimi i Shkollave fillore Gjergj Fishta, Ismail Qemali, Asim Vokshi, Dardani, Naim Frashri, Pjeter Bogdani, Shkolla e Gjelbert dhe Mehmet Xhevari ” me nr. prokurimit: 616-19-3237-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- Kuvendi Komunal Prishtinë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1, 7 dhe 59 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 09.01.2020, ka autorizuar ekspertin profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti profesional i prokurimit në raportin e dt: 16.01.2020 sqaron si në vijim:

Përgjigje në Pretendimin

Lidhur me pretendimin e OE ankues ”Laguna’ Shpk se AK gjate fazës së rivlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve ka eliminuar ofertën e tyre me arsyetimin se oferta e tyre nuk është e mjaftueshme për pagesën e pagave për 83 punëtorët e kërkuar sipas kërkesës se dosjes së tenderit, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Në ankesën e parashtruar në OSHP, operatori ekonomik “Laguna” Shpk ka prezantuar një analizë se si llogaritet paga për 83 punëtorë me të gjitha komponentët tjera.

$$83 \times 282.50 = 23,447.5$$

$$23\,447.5 \times 18\% \text{ tvsh} = 4,220.55$$

$23\,447.5 + 4220.50 = 27,668.05$

$27\,668.05 + 1390 \text{ përvaja} = 29,058.05$

$29,058.05 + 1172.79(5\% \text{ kontribute}) = 30,230.84$

$30\,230.84 \times 36 \text{ muaj} = 1,088,310.24 \text{ euro}$

Ndërsa çmimi i Laguna sh.p.k për 3 vite është 1,089,213.39 euro

Nga analiza e më sipërme e OE ankues eksperti shqyrtues sqaron se kjo analize është jo korrekte dhe nuk është kalkuluar në përputhje kërkesat e dosjes së tenderit dhe interpretimin e ATK-së. Nga kjo analizë rezulton që OE ankues ka kalkuluar TVSH-në vetëm për pagën bruto prej 282.50 €, ndërsa për përvajën e punës dhe kontributin pensional të punëdhënësit (5%) nuk ka kalkuluar TVSH-në që paraqet një përlllogaritje jo të saktë.

Analiza e prezantuar nga AK në përgjigjen ndaj kërkesës për rishqyrtim është e saktë dhe çdo ofertë me çmim më të ulët se kjo analizë duhet të shpallet e papërgjegjshme sepse nuk mbulon pagesën e pagave të kërkuar në dosjen e tenderit.

Pagabruto per 1 puntore	282.50
Përvoja e punës(1390/83)	16.75
Totali i pagës me përvoj	299.25
Kontrib pension punedhënsi 5%	
(299.25x5%)	14.96
Totali i pages	314.21
pagat per 83 punëtor	26,079.38
TVSH 18%	4,694.29
Totali i pages me TVSH	30,773.66
Totali i pages per 36 muaj	1,107,851.85

Konstatohet se pretendimi i ankuesit i OE ankues është i pa bazuar dhe AK ka vepruar konform vendimit të OSHP-së nr 638-657/19 dhe interpretimit të ATK-së

Mendimi i ekspertit profesional: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet si e pabazuar dhe rekomandon autoritetin kontraktues që të vazhdojë me lidhjen e kontratës.

Operatori ekonomik përmes parashtresës me shkrim të datës 17.01.2020 ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me raportin e ekspertit profesional.

Autoriteti Kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datës 17.01.2020 ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me raportin e ekspertit profesional.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 05.02.2020, pa praninë e palëve konform nenit 26.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtruesat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Laguna" Shpk se AK gjatë fazës së rivlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve ka eliminuar ofertën e tyre me arsyetimin se oferta e tyre nuk është e mjaftueshme për pagesën e pagave për 83 punëtorët e kërkuar sipas kërkesës së dosjes së tenderit, Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit sqaron se në ankesën e parashtruar në OSHP nga operatori ekonomik ankues "Laguna" Shpk është bashkangjitur një analizë se si llogaritet paga për 83 punëtorë me të gjitha komponentët tjerë.

$$83 \times 282.50 = 23,447.5$$

$$23,447.5 \times 18\% \text{ TVSH} = 4,220.55$$

$$23,447.5 + 4,220.55 = 27,668.05$$

$$27,668.05 + 1390 \text{ përvoja} = 29,058.05$$

$$29,058.05 + 1172.79 \text{ (5\% kontribute)} = 30,230.84$$

$$30,230.84 \times 36 \text{ muaj} = 1,088,310.24 \text{ euro}$$

Ndërsa çmimi i Laguna sh.p.k. për 3 vite është 1,089,213.39 euro

Nga analiza e më sipërme e OE ankues, Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit sqaron se kjo analizë është jo korrekte dhe nuk është kalkuluar në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit dhe interpretimin e ATK-së. Nga kjo analizë rezulton që OE ankues ka kalkuluar TVSH-në vetëm për pagën bruto prej 282.50 €, ndërsa për përvojën e punës dhe kontributin pensional të punëdhënësit (5%) nuk ka kalkuluar TVSH-në që paraqet një përlllogaritje jo të saktë. Analiza e prezantuar nga AK në përgjigjen ndaj kërkesës për rishqyrtim është e saktë dhe çdo ofertë me çmim më të ulët se kjo analizë duhet të shpallet e papërgjegjshme sepse nuk mbulon pagesën e pagave të kërkuara në dosjen e tenderit.

Paga bruto për 1 punëtor	282.50
Përvoja e punës(1390/83)	16.75
Totali i pagës me përvojë	299.25
Kont. pensional i punëdhënësit	
5% (299.25x5%)	14.96
Totali i pagës	314.21

pagat për 83 punëtor	26,079.38
TVSH 18%	4,694.29
Totali i pagës me TVSH	30,773.66
Totali i pagës për 36 muaj	1,107,851.85

Paneli shqyrtues duke u bazuar në ecurinë e këtij aktiviteti të prokurimit, në shkresat e lëndës të cilat i ka pas në dispozicion si dhe në sqarimet e ekspertit profesional të prokurimit vlerëson se Autoriteti Kontraktues gjatë vlerësimit të ofertave për këtë aktivitet të prokurimit ka vepruar në pajtim me nenin 59 të LPP-së, për faktin se ka rekomanduar për dhënie të kontratës operatorin ekonomik i cili ka plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Gjithashtu Paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit ka pasur në konsideratë nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK- Kuvendi Komunal Prishtinë
- 1x1 OE- "LAGUNA"SH.P.K-Prishtinë
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.